

VENDIM
Nr. 121, datë 5.3.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË NUMRIN E PUNONJËSVE TË MIRATUAR PËR MINISTRINË E
ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT, PËR VITIN 2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit bëhet, gjithsej, 647 veta.
2. Shtesa prej 30 punonjësish i kalon Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe përballohet nga numri rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama